



Raporti nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

7 janar – 31 korrik 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје**

Raport nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

(7 prill – 31 korrik 2016)

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Agjencisë zvicerane për përkrahje dhe zhvillim.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyre nuk i reflekton pikëpamjet e Agjencisë zvicerane për përkrahje dhe zhvillim.



Instituti për demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015¹. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Qëllimi i monitorimit të medieve është për të ardhur në njohuri se në të cilën masë mediet janë pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht se në çfarë mase opinionit më të gjerë i ja transmetojnë argumentet e shfaqura në debatet kuvendore.

Para jush është raporti i parë për raportimit mediatik për Kuvendin që ka të bëjë me periudhën katër-mujore prej 7 prillit deri më 31 korri të vitit 2016.

Rezyme

- Raportimi nga debatet në seancat u ul në nivelin më të ulët deri tani krahasuar me periudhat paraprake në periudhat e monitoruara shtator – dhjetor 2015 dhe janar – 6 prill 2016.
- Mediat më shpesh publikojnë informacione në të cilat deputetët komentojnë ngjarje të tjera që cilat nuk janë të ndërlidhura me Kuvendin. Në vendin e dytë janë informacionet në të cilat Kuvendi vetëm përmendet, por përmbajtja nuk ka të bëjë me punën e tij, por me krizën politike dhe raportet midis partive më të mëdha.
- Nga diskutimet parlamentare më shpesh informojnë nga seancat në të cilat u diskutua për rishikimin e Buxhetit për vitin 2016 dhe për marrjen borxh përmes euro-bondit, për abonimin dhe iniciativën për impigment të presidentit Ivanov si dhe për reformat zgjedhore si dhe për pastrimin e listave zgjedhore dhe ndryshimin e kodit zgjedhor si rezultat i mos-mbajtjes së zgjedhjeve më 24 prill dhe më 5 qershor.
- Burime më shpesh të konsultuara në informacionet e botuara janë deputetët, por përfaqësimi i tyre është në nivel më të ulët krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara. Në vendin e dytë sipas përfaqësimit janë partitë politike, e mandej ministrat qeveritar.
- Në pjesën më të madhe të informacioneve në të cilat si burime janë të theksuar deputetët nga një opion politik, ndërsa në pjesë më të vogël në të njëjtën kohë deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita.
- Utrinski vesnik publikoi gjithsej më shumë informacione (25%) në të cilat përmenden Kuvendi dhe deputetët ose kanë të bëjnë me punën e parlamentit. Në vend të dytë në këtë periudhë është Dnevnik (19%), ndërsa e treta është Koha (18%).

¹ Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatik u zhvillua në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz. Përforcimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ” i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

- Përqindja më e madhe e informacioneve të publikuara në MTV 2 (58%) dhe në Tellma (54%) fokusohen në debatet në seancat. Dnevnik (62%), Sitel (42%) dhe Veçer (39%) më shpesh publikojnë informacione të cilat nuk janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me Kuvendin. Alsat-M (42%), Sloboden pečat (44%), Koha (41%) dhe Utrinski vesnik (35%) më shpesh e përmend Kuvendin në kontekstin e ngjarjeve të tjera politike në shtetin.
- Televizioni “Tellma” më shpesh publikonte informacione në të cilat në të njëjtën kohë janë të përfaqësuar deputetët e të dy opsioneve politike në parlamentin dhe në pjesën më të madhe të informacioneve të publikuara edhe nga televizioni “Alsat-M” (67%) edhe nga “MTV 2” (58%). Në 75% të informacioneve e publikuara në gazetën “Sloboden pečat” burime janë deputetë vetëm nga pozita, ndërsa në gazetën “Veçer” në 71% burime janë vetëm deputetë nga shumica.
- E rritur është përqindja e informacioneve në të cilat është theksuar vetëm një burim dhe informacionet ishin burime dhe informacionet ishin burim krahasuar me periudhën paraprakisht të monitoruar. Në llogari të kësaj kanë rënë informacionet në të cilat janë theksuar dy, tre ose më tepër se tre burime.
- Informacionet e publikuara që kanë të bëjnë me Kuvendin më shpesh janë të strukturuar si raporte informative (61%) ose lajme të shkurtra me informacione bazike për ngjarjet (14%). Gjithsej 13% shkojnë në shkrime të cilat krahas elementeve informative dhe analitike. Nga 6 % të informacioneve për Kuvendin janë të strukturuar si analiza ose komente.

I. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Deputeti i BDI-së, Zulfi Adili, në shtator paralajmëroi se e braktis grupin parlamentar dhe se do të vazhdojë të merr pjesë në punën e Kuvendit si deputet i pavarur. Me këtë grupi i deputetëve i BDI-së numëron 19 deputetë. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvendin, vendosi ta braktis koalicionin pushtet-mbajtës. Në periudhën nga 20 qershori i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Nga 1 shtatori i vitit 2015 koalicioni opozitar e udhëhequr nga LSDM u kthye në Kuvendin dhe punoi me përbërje të plotë deri në vendimin për shpërbërje të tij të votuar më 7 prill të vitit 2016 me qëllim që të mbahen zgjedhje më 5 qershor të vitit 2016. Më 18 maj të vitit 2016 pas vendimit të Gjykatës kushtetuese që ti ndërpresë veprimet zgjedhore dhe ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e zgjedhjeve të shpallura, Kuvendi të njëjtën ditë me shumicë vendosi që ta shtyjë për kohë të pacaktuar mbajtjen e zgjedhjeve. Në periudhën e monitoruar, dhjetor 2015 – prill 2016 shumica në pushtet në Kuvendin numëron 81 deputet, ndërsa opozita 42 deputetë.


Nga 14 janari i vitit 2016 në krye të Qeverisë është i ashtuquajtur kryeministri “teknik” Emil Dimitriev, në vend të liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Kriza u thellua në mënyrë shtesë pas shpalljes së abolicionit nga presidenti i shtetit Gjorgje Ivanov më 12 prill të vitit 2016. Ivanov në fjalimin e tij të drejtuar qytetarëve me arsyetim se dëshiron ta qetësojë krizën, shpalli se ka nënshkruar vendime për abolicion të 56 personave midis të cilave edhe liderët e partive më të mëdha Nikolla Gruevski të VMRO-DPMNE dhe Zoran Zaev të LSDM-së. Abolicioni i Ivanovit shkaktoi protesta masive të qytetarëve dhe të opozitës dhe kundër-protesta në Shkup dhe në disa qytete në shtetin në të cilat kërkohet dorëheqja e tij dhe tërheqje e vendimit me qëllim që të gjitha rastet që i ngre PSP të mund të trajtohen në mënyrë përkatëse juridike. Me arsyetim se Presidenti i Republikës me abonimin në grup i ka shkelur ingerencat dhe autorizimet e veta, opozita në maj të vitit 2016 në Kuvendin ngriti procedurë për impçiment përkatësisht për përcaktim të përgjegjësisë së Presidentit Gjorgje Ivanov që është rasti i parë i tillë në historinë e Maqedonisë. Sipas procedurës, Presidenti gjatë procedurës kuvendore kishte mundësi dy herë që personalisht të dëshmojë, por ai nuk e shfrytëzoi atë të drejtë që personalisht të paraqitet në parlamentin e as në komisionin e themeluar me kompetencë speciale që të diskutojë për kërkesën për përgjegjësi të tij e as në seancën plenare që ti arsyetojë procedurat e veta përmes ndonjë letre. Shumica parlamentare në fund e hodhi poshtë propozimin për përgjegjësi të Presidentit Ivanov për abolicion të grupit të personave, me të cilën gjë nuk pati sukses iniciativa e opozitës.

Periudha e gjithëmbarshme të monitorimit të mbuluar me këtë raport katër-mujor (7 prill – 31 korrik 2016) kaloi në shenjë të polarizimit të fuqishëm politik midis dy partive më të mëdha politike VMRO-DPMNE dhe LSDM, si pasojë e negociatave ende të pa përfunduara për dalje nga kriza politike rreth mbajtjes së zgjedhjeve të reja të parakohshme parlamentare.

II. Gjetja nga monitorimi


- **Fokusi i informacioneve të publikuara**

Në periudhën e monitoruar nga 7 prilli deri më 31 korrik të vitit 2016 janë identifikuar dhe analizuar 575 informacione të publikuara në mediat e monitoruara në të cilat përmendet ose që kanë të bëjnë me Kuvendin dhe deputetët. Me këtë rast, nga mediat e monitoruara më shumë informacione të tilla janë identifikuar te gazeta Utrinski vesnik (25%), e mandej edhe te gazetatat Dnevnik (19%), Koha (18%) dhe Veçer (15%). Televizionet në përgjithësi më pak raportojnë për ngjarjet e ndërlidhura me parlamentin, e me këtë rast informacione të tilla janë identifikuar në MTV 2 (6%).




Analiza e k[tyre përmbajtjeve vë në pah se në këtë periudhë (7 prilli deri më 31 korrik të vitit 2016) mediet më shpesh transmetojnë qëndrime të deputetëve, por për ngjarje të tjera të cilat nuk janë të

lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e Kuvendit (29%). Kjo në masën më të madhe ka të bëjë edhe me paraqitjen e deputetëve të cilët kanë komentuar ngjarje të tjera politike në pres konferencat partiake. Në të njëjtën kohë kjo është rritje e konsiderueshme e informacioneve me fokus të tillë duke pasur parasysh se në periudhat e monitoruara paraprake të tilla kanë qenë vetëm 7% në periudhën nga 1 janari deri më 6 prill të vitit 2016 dhe 8% në periudhën nga shtatori i vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2015. Sipas fokusit të medieve në vend të dytë janë informacionet në të cilat Kuvendi vetëm përmendet (28%) , por ato në esencë nuk kanë të bëjnë me asnjë segment të punës së tij. Në këto informacione Kuvendi më shpesh përmendet në kontekst të krizës politike, negociatat, protestat që ndodhën në atë periudhë si dhe me zgjedhjet e paralajmëruara të parakohshme. Informacionet që i bëjnë vështrim debatit, argumentet dhe pozicionet e deputetëve rreth temave nga rendi i ditës i Kuvendit janë në vendin e tretë sipas përfaqësimit dhe në të njëjtën kohë janë më të rralla krahasuar me periudhat paraprake. Ndërkaq, në këtë periudhë (7 prilli deri më 31 korrik të vitit 2016) gjithsej 20% nga informacionet kanë të bëjnë me debatet parlamentare në seancat parlamentare krahasuar me 32% nga periudha paraprake (1janar – 6 prill 2016) dhe 43% nga periudha e parë e monitoruar (1 shtator – dhjetor 2016).



Nëse analizohet raportimi veç e veç të medieve, pjesa më e madhe e informacioneve të publikuara për Kuvendin në MTV 2 (58%) dhe në Tellma (54%) kanë të bëjnë me debatet në seancat. Dnevnik (62%), Sitel (42%) dhe Veçer (39%) më shpesh në informacionet e publikuara fokusohen në deputetë të cilët komentuan ngjarje të tjera të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me Kuvendin. Në kontributet e Alsat-M (42%) dhe në tekstet në gazetat Sloboden pečat (44%), Koha (41%) dhe Utrinski vesnik (35%) Kuvendi më shpesh vetëm është përmendur në kontekst të ngjarjeve të tjera politike. Gazeta Lajm më shpesh u fokusua në përgjithësi në punën e Kuvendit dhe raportet midis partive politike në parlamentin duke mos hyrë në detaje të diskutimeve.




Gjatë raportimit për diskutimet në seancat parlamentare mediet më shpesh u fokusuan në seancat me konfrontim më të fuqishëm politik dhe në atmosferën e polarizuar midis deputetëve të blloqeve të kundërshtuara politike. Vëmendja mediatike në Kuvendin më shumë u tërhoq nga debatet për rishikimin e Buxhetit përmes euro-bondit, iniciativën për impiçment të Presidentit Ivanov dhe vendimet për abonim të politikanëve, caktimi i zgjedhjeve dhe ndryshimet në Kodin zgjedhor, pastrimi i listës zgjedhore, puna e Prokurorisë speciale publike, reformat mediatike dhe negociatat politike në Përzihino për tejkalimin e krizës politike si dhe rreth rolit të ndërmjetësve të huaj dhe të diplomatëve në negociatat.

Fokusi i informacioneve të publikuara është e prezantuar përmes rresë semantike prej 100 fjalëve më shpesh të përdorura nga mediat në titujt dhe nën-titujt në gazetatat dhe në paralajmërimet e kontributeve televizive në të cilat përmendet Kuvendi.


Nëse analizohet sipas llojit të burimeve të cilat janë konsultuar, rezulton se mediet më rrallë konsultojnë deputetë krahasuar me periudhat paraprake.

Në periudhën e fundit (7 prill – 31 korrik 2016) në 34% të informacioneve si burime janë theksuar deputetë që është më pak për 6% dhe të ministrave të qeverisë për 4%. Përfaqësuesit e institucioneve të tjera janë theksuar si burime në 12% të informacioneve, ndërsa mbetet e lartë përqindja e burimeve të cilat llogariten si “të tjera” – 12%. Nën “të tjera” konsiderohen edhe përfaqësues të huaj, diplomatë ose parlamentarë nga shtete të tjera të cilat kanë komentuar rreth Kuvendit. Shpeshësia e burimeve nga partitë politike mund të ketë të bëjë me negociatat e liderëve dhe marrëveshjeve për shpërbërje të parlamentit, si dhe me reagimet me rastin e abonimit që e bëri presidenti dhe iniciativat për shlyerje të saj përmes Kuvendit.




Sipas fokusit të teksteve të publikuara dhe të kontributeve në mediat e monitoruara rezulton se deputetët si burime më shpesh janë theksuar kur është raportuar për debatet parlamentare në seancat plenare (56%) dhe në seancat e komisioneve (50%). Deputetët si burime janë më të përfaqësuar edhe kur ata komentojnë ngjarje të tjera të cilat nuk janë të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e parlamentit. Në informacionet në të cilat Kuvendi vetëm përmendet burimet më shpesh të theksuara janë partitë politike (25%) dhe institucione të tjera në shtet (18%), ndërsa në vend të tretë janë burime “të tjera” në të cilat dominojnë përfaqësues dhe diplomatë të huaj.


Në rastet kur mediat raportojnë në përgjithësi për Kuvendin si burime krahas deputetëve (24%) konsultuan edhe përfaqësues të partive politike (25%) si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore (22%). , në vend të dytë janë përfaqësues të pushtetit ekzekutiv përkatësisht ministra qeveritar. Kështu gjatë raportimit për debatet në komisionet 23% të burimeve shkojnë në ministrat, ndërsa në seancat parlamentare 32%.




Në informacionet në të cilat si burime janë theksuar deputetë, nëse analizohet se cilit opion politik në parlamentin ata i takojnë, rezulton se sërish është zvogëluar numri i informacioneve në të cilat janë përfshirë në të njëjtën kohë edhe pushteti edhe opozita. Pjesa më e madhe e informacioneve janë publikuar me deputetë nga një vetëm një opion politik (63%). Me këtë rast mediat në këtë periudhë më shpesh publikonin informacione Me këtë rast mediat në këtë periudhë më shpesh publikonin informacione në të cilat si burime janë theksuar vetëm deputetë nga shumica në pushtet (34%), ndërsa më rrallë vetëm me deputetë opozitar (29%). Në 37% të rasteve si burime janë identifikuar njëkohësisht deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita.



Shikuar veç e veç, sipas mediumit i cili e ka publikuar informacionin në të cilin përmendet Kuvendi ose deputetët, televizioni "Tellma" më shpesh ka publikuar informacione në të cilat njëkohësisht janë të përfaqësuar deputetë nga të dyja opsionet politike (91%). Deputetët nga dy opsionet politike në parlament janë prezantuar edhe në pjesën më të madhe të informacioneve të publikuara edhe nga televizioni "Alsar-M" (67%) edhe nga "MTV 2" (58%). Në 75% të informacioneve e botuara në gazetën "Sloboden pečat" burime janë vetëm deputetë të opozitës, ndërsa në gazetën "Veçer" në 71% të rasteve burime janë vetëm deputetë të shumicës.




Nëse analizohet sipas fokusit të informimit, mediat më shpesh publikojnë informacione me deputetë nga të opsionet kur raportohet nga debati në komisionet kuvendore (86%) edhe nga seancat plenare (71%). Në informacionet në të cilat deputetët komentojnë ngjarje të tjera të cilat nuk janë të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me Kuvendit më shpesh janë përfaqësuar deputetë nga pushteti (64%), ndërsa më rrallë nga opozita (25%). Në rastet kur mediet fokusohen në përmbajtje të ligjit që hyn në fuqi, shlyhet ose ndryshon, më shpesh ishin të përfaqësuar deputetë nga opozita (52%), ndërsa më rrallë nga pushteti (24%).



- **Zhanri i informacioneve të publikuara**

Nga informacionet e analizuara në të cilat përmendet Kuvendi, të publikuara nga mediet e monitoruara në periudhën prej 7 prilli – 31 korrik të vitit 2016, pjesa më e madhe janë të strukturuar në formë të raporteve informative nga ngjarjet. Të tilla janë 61% nga informacionet e publikuara. Në ato vetëm më shpesh vetëm transmetohen informacione për ngjarjet duke mos bërë analizë ose duke mos hyrë në kontekstin më të gjerë të ngjarjeve ose të jepet pasqyrim komparative ose historik. Sipas karakteristikave të zhanrit në vend të dytë sipas përfaqësimit janë lajmet e shkurtra (14%) në të cilat vetëm theksohen informacione themelore për ngjarjet. Mandej vijnë shkrimet në gazetatat ose temat në televizionet (13%), në të cilat krahas elementeve informative janë përfaqësuar edhe elemente analitike. Komentet, intervistat dhe analizat, si zhanre gazetareske, janë më pak të përfaqësuara gjatë raportimit për punën dhe ngjarjet në Kuvendin. Në komentet dhe analizat shkojnë nga 6%, nga numri i tërësishëm i informacioneve të publikuara. Vetëm 1% nga informacionet janë intervista.



Informacionet në të cilat përmendet ose që kanë të bëjnë me Kuvendin dhe deputetët në mënyrë dominante (97%) janë publikuar në rubrikat e para ose më të rëndësishme në mediat. Vetëm 1% nga informacionet në këtë periudhë janë publikuar në rubrikat “Ekonomi/Biznes”, ndërsa të tjerat 2% në rubrikat e tjera.

Me këtë rast, në 71% të rasteve informacionet janë të nënshkruara nga autor, ndërsa në 29% nuk ka autor të nënshkruar. Në pjesën më të madhe të rasteve në të cilat nuk ka autor të nënshkruar shkojnë në lajmet e shkurtra në të cilat transmetohen informacione themelore për ngjarjet. 52% të informacioneve të publikuara në këtë periudhë ishin të paralajmëruara në faqen ballore të gazetave ose në paralajmërimin e përgjithshëm (forshpan) në televizionet.

III. Metodologjia e hulumtimit

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

Gazeta

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat

- Koha
- Lajm

Televizione

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediumet e përmendura vijohen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët ose procedura ligjvënëse. Në çdo tekst dhe kontribut televiziv veç e veç analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji dhe numri i burimeve si dhe nga cili opSION politik janë deputetët të cilët janë theksuar si burime të informacioneve dhe nëse ato janë theksuar ose janë anonim. Nga titujt dhe nëntitujt si dhe nga paralajmërimet televizive të kontributeve në të cilat përmendet Kuvendi përpilohen rretë semantike. Këto rre të fjalëve më të përdorura nga mediat janë indikative për kontekstin, temat dhe ngjarjet në të cilat përmendet Kuvendi në periudhën e monitoruar.

IV. Struktura mediatike dhe gjuhësore e publikimeve

Struktura e përmbajtjeve mediatike të analizuara në periudhën shtator – dhjetor të vitit 2015 është si vijon:

Sipas llojit të mediumit: gazeta ditore 86%, televizione 14%;

Gjuha e publikimit: maqedonisht 66%, shqip 34%,

Informacione në gazetat sipas gjuhës: maqedonisht 73%, shqip 27%,

Informacione në televizionet sipas gjuhës: shqip 72%, maqedonisht 28%.

Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatik për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptcionet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi i projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforcimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – IEDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.



Raporti nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

7 Janar – 31 korrik 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје**